

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një ditë tejet e rëndësishme, sepse po diskutohet projektbuxheti i vitit 2023 që, në fakt, në këtë moment krize ekonomike duhet t'u jepte përgjigje reale shqetësimeve të qytetarëve, të cilët mezi mbyllin muajin; t'i jepte përgjigje dramës së madhe të largimit të të rinjve me gomone nga vendi, sepse prej vitit 2014 nga Shqipëria janë larguar 740 mijë qytetarë, ndërkohë që kjo maxhorancë nuk zgjodhi të bëjë një buxhet për qytetarët, por zgjodhi të bëjë një buxhet për klientët e saj.

Nëse kjo qeveri do të mendonte për ndalimin e shpopullimit, buxheti i parë që duhej të kishte mbështetur për të përmbushur të gjitha nevojat e tij është buxheti i arsimit. Por çfarë ndodh? Faktet dhe vendimmarrja e kësaj maxhorance me këtë projektbuxhet tregojnë të vërtetat e kësaj qeverie, e cila nuk i ka aspak prioritet arsimin, të rinjtë apo familjet shqiptare. Buxheti për arsimin do të vazhdojë të jetë më i ulëti në rajon me 2,2% të prodhimit të brendshëm bruto për vitin 2023, duke qenë shumë larg mesatares së Bashkimit Europian dhe premtimit të kësaj maxhorance për të arritur në 5% të prodhimit të brendshëm bruto të buxheti të arsimit.

Sot kjo qeveri i ktheu përgjigje një peticioni të 6 mijë studentëve, të cilët kërkonin mbështetje financiare me 100 euro në muaj, aq sa bashkëmoshatarët e tyre në Kosovë. E dini sa duhet të shpenzojnë studentët në muaj për të përballuar krizën e çmimeve? Të paktën 500 euro, pa llogaritur këtu tarifën e studimeve, ushqimet, qiratë e rritura nga 300-400 euro, transportin publik e të tjera. Pra, qeveria u tha studentëve sot që nuk do të keni mbështetje financiare nga kjo qeveri.

Për këtë maxhorancë të rinjtë nuk ekzistojnë si kategori që duhet mbështetur. Studentët nuk kanë qenë të planifikuar për t'u mbështetur në asnjë nga aktet normativ, që kanë sjellë në këtë Kuvend, të cilët kërkojnë një mbështetje sa Kosova, e cila, edhe pse me një buxhet më të ulët se Shqipëria, i ka mbështetur dhe i mbështet çdo muaj studentët e saj. Kostoja e mbështetjes për studentët do të ishte 12,5 milionë euro në muaj, pak më shumë se gjysmëkilometri rrugë e flarinjtë e kësaj maxhorance.

Nga ana tjetër, çfarë po ndodh me pedagogët me këtë projektbuxhet? Ky buxhet nuk përmbush kërkesat e pedagogëve, të cilët protestojnë prej javësh për një trajtim me një pagë më dinjitoze dhe arsim cilësor, por qeveria u mjaftua me një mbështetje prej 7%, e pamjaftueshme dhe totalisht tallëse për pedagogët. Ata kërkojnë, njëllon si studentët, të mbështeten dhe të arrijnë pagën e kolegëve të tyre në Kosovë për dy vjetët e ardhshëm, por përsëri asnjë zë që të parashikonte dhe të përmbushte kërkesat e drejta të pedagogëve.

Nga ana tjetër, kërkimi shkencor, që ishte edhe një nga kërkesat e tjera të pedagogëve, për të rritur cilësinë e edukimit dhe për t'i kthyer universitetet tona në universitete, të cilat rrisin cilësinë dhe kërkimin shkencor, do të vazhdojë të jetë i nënfinancuar me 0,04%-0,05% të prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që në progres-raportin e fundit të Bashkimit Europian citohet fakti që buxheti i arsimit është i ulët, që standardi që do të duhet të arrijmë si Shqipëri është 1% e prodhimit të brendshëm bruto për kërkimin shkencor.

Nga ana tjetër, nuk ka asnjë zë në buxhet për kampusin e Universitetit të Tiranës, një premtim i kësaj maxhorance. Çdo muaj bëhen dhe ndryshohen projekte, por asnjë zë në buxhet për kampusin e Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, në buxhet nuk ka asnjë zë për kampusin e Universitetit të Durrësit, që sot nuk ka godinë, konvikte dhe kampus për studentët që do të duhet të akomodojë.

E dini sa rritje planifikon ky buxhet për investimet e brendshme, për laboratorë, për fusha sporti, të cilat janë aq të nevojshme, dhe për infrastrukturë ngrohjeje? Një rritje vetëm me 3 milionë lekë ose 0,07% e prodhimit të brendshëm bruto, ndërkohë që kërkesat janë në stratosferë, sepse nuk na mjafton thjesht godina, por që këto godina të kenë laboratorë, të kenë fusha sporti, të kenë infrastrukturë për të ofruar një cilësi arsimit, sikundër e kërkojnë nxënësit tanë.

Për sa i përket rritjes së pagës së mësuesve me 6%, për të cilën u fol edhe sot këtu, kjo gjë do të ndodhë në korrik të vitit 2023. Çfarë do të bëjnë këta mësues deri në atë kohë, edhe pse 6% është një shifër totalisht e pamjaftueshme për të përballuar inflacionin që do të rritet, koston e jetesës së mësuesve, të cilët thuhet me krenari që punojnë edhe në verë? Nuk është krenari që një mësues punon gjatë sezonit veror, përkundrazi, është një reflektim që duhet ta bëjmë të gjithë, sepse gjatë verës, nëse nuk e dini, mësuesit duhet të punojnë për rritjen e kapaciteteve të tyre, për rritjen e cilësisë së tyre dhe jo të jenë të detyruar të punojnë, sepse nuk arrijnë të përmbushin kostot e familjes së tyre.

Pra, mësues të dashur, me gjithë respektin tim personal dhe të shumë shqiptarëve për ju, duhet të kuptoni që 6%-i i rritjes së pagës që do t'ju bëhet nga kjo maxhorancë në vitin 2023 do të fillojë në korrik dhe është totalisht e pamjaftueshme që ju të përballoni të gjitha sfidat që keni përpara.

Të mos flasim për propagandën e librave falas nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, që është përsëri një premtim i pambajtur. Ne po kërkojmë të realizoni atë që thoni në letra dhe atë që raportoni në progresraporte apo raportet periodike që bëhen pranë Komisionit European, sepse të gjithë shqiptarët e kanë kuptuar që ata janë libra të përdorur, jashtë funksionit (të gjithë fëmijët dhe prindërit shprehin shqetësimin e madh që kanë me këto libra), që nuk janë falas, por janë të përdorur. Ndaj, do të duhet që ky buxhet ta kishte adresuar këtë shqetësim dhe nga klasa e parë deri në klasën e nëntë çdo vit të ofroheshin libra falas për fëmijët.

Ku shkojnë paratë e shqiptarëve? Shkojnë për pagesat e PPP-ve në shumën 950 milionë euro; shkojnë për inceneratorin e Tiranës në shumën 34 milionë euro për 3 vjetët e ardhshëm, edhe pse nuk ekziston dhe nuk ofron asnjë shërbim.

Vetëm pagesat e interesave dhe shërbimit të borxhit arrijnë shifrën 141 miliardë lekë për vitin 2023, e barabartë kjo me buxhetin e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe bujqësisë ose sa fondi i pensioneve.

Pra, kjo qeveri do t'i shtojë taksat dhe tatimet për 99% të qytetarëve, që t'ua bëjë peshqesh 1% të klientëve të saj.

Të nderuar qytetarë,

Fatkeqësisht, ky nuk është buxhet për njerëzit. Ky është buxheti për klientët e kësaj maxhorance.

Ky nuk është buxheti që duhet t'u vinte në ndihmë qytetarëve sot për përballimin e krizës ekonomike, por është buxheti i pagesave të PPP-ve dhe inceneratorit të Tiranës.

Ky nuk është buxheti që do të duhej t'i jepte shpresë rinisë për të qëndruar këtu, që do të duhej t'u jepte shpresë shumë qytetarëve, intelektualëve, që po mendojnë të lënë vendin.

Ndaj ne propozojmë amendamente tona për secilën nga problematikat që unë shtrova, por edhe për shumë problematika të tjera, që t'ju japim shansin ta ktheni buxhetin e PPP-ve në buxhetin e njerëzve dhe të shqiptarëve.

Faleminderit!